

LIGJ
Nr. 13/2023

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
PËR RIKTHIMIN E IKONAVE TË TRAFIKUARA NË VENDIN E TYRE TË
ORIGINËS**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut për rikthimin e ikonave të trafikuara në vendin e tyre të origjinës sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar më datë 2.2.2023.

Shpallur me dekreten nr. 31, datë 15.2.2023 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DHE

REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

PËR

**KTHIMIN E IKONAVE TË TRAFIKUARA NË VENDIN E
TYRE TË ORIGINËS**

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Kulturës. Rr "Aleksandër Moisiu" nr. 76, ish Kinostudio " Shqipëria e Re", Tiranë, Shqipëri

dhe

Republika e Maqedonisë së Veriut, e përfaqësuar nga Ministria e Kulturës, 61 Gjuro Gjakovikj Str., Skopje (në vijim të referuara si "Palët"):

Në bazë të dispozitave të Konventës së UNESCO-s të 14 nëntorit 1970 "*Mbi njetet e ndalimit dhe paandalimin e transportit ilegal, eksportin dhe transferimin e Pronësive të Pasurisë Kulturore*" në të cilën Republika e Shqipërisë dhe Republika e Maqedonisë së Veriut janë palë.

Në frymën e forcimit dhe nxitjes së bashkëpunimit dhe me bindjen se ky bashkëpunim do të kontribuojë në forcimin e miqësisë dhe mirëkuptimin e ndërsjellë midis dy vendeve, në përputhje me Marrëveshjen e Bashkëpunimit në fushën e kulturës ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të nënshkruar në Tiranë më 16 nëntor 2005,

SI DHE

DUKE MARRË PARASYSH SE:

- Në vitin 2013 Policia e Shtetit të Republikës së Shqipërisë sekuestroi 476 objekte/vepra të dyshuara trashëgimi kulturore dhe filloi procedimin penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Republika e Shqipërisë. Objektet e sekuestruara, me statusin e provës materiale, lëvizën pranë mjediseve të Muzeut Historik Kombëtar në mbrojtje të përkohshme deri në mbylljen e procedurave gjyqësore;
- Me përfundimin e veprimeve hetimore dhe vendimet e formës së prerë në të gjitha shkallët e gjyqimit të sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë ngriti një grup pune për vlerësimin dhe kategorizimin e objekteve trashëgimi kulturore, tashmë të kaluara në pronësi të shtetit shqiptar;

- Në vitin 2018 Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të dispozitave të Konventës së UNESCO-s të 14 nëntorit 1970 "Mbi mjetet e ndalimit dhe parandalimin e transportit ilegal, eksportin dhe transferimin e Pronësisë së Pasurisë Kulturore", ngriti pretendimin për pronësinë e disa prej objekteve të sekuestruara;
- Konkluzionet e përcaktuara në raportin përfundimtar të Grupit të Punës të ngritur me Urdhër Nr. 122 Prot., datë 19.02.2018, në të cilin është shprehur se "ikonat e pretenduara nga Republika e Maqedonisë së Veriut përputhen me ikonat të cilat kanë kaluar në pronësi shtetërore me vendimin nr. 1502, datë 16.06.2015 të Gjykatës Penale të Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me Vendimin nr. 1459, datë 30.09.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë, vendimin nr. 1613, datë 30.06.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- Konkluzionet e përcaktuara në raportin përfundimtar të Grupit të Punës të ngritur me Urdhër Nr. 122 Prot., datë 19.02.2018, në të cilat grupi i punës është shprehur se objektet e sipërcituara janë objekt i zbatimit të dispozitave të Konventës së UNESCO-s 1970 "Mbi mjetet e ndalimit dhe parandalimin e transportit ilegal, eksportin dhe transferimin e pronësisë së pasurisë kulturore" dhe ligjit nr.27/2018 datë 17.05.2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë";
- Pas shqyrtimit të dokumentacionit të plotë, raportit përfundimtar të Grupit të Punës të ngritur me Urdhër Nr. 122 Prot., datë 19.02.2018, pas mbylljes së të gjitha proceseve gjyqësore ndaj trafikuesve të tyre.

bien dakord sa më poshtë:

Neni 1 Objekti i Marrëveshjes

Objekti i kësaj marrëveshjeje është kthimi i 20 (njëzet) ikonave të trafikuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut të cilat gjenden të sekuestruara në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të detyrimeve të përcaktuara të Konventës së UNESCO-s 1970, "Mbi mjetet e ndalimit dhe parandalimin e transportit ilegal, eksportin dhe transferimin e Pronësisë së Pasurisë Kulturore" dhe Ligjit Nr. 27/2018, datë 17/05/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" në Republikën e Shqipërisë, kanë kaluar në pronësi të shtetit shqiptar sipas vendimeve gjyqësore të gjykatave shqiptare ndërsa sipas raportit përfundimtar të grupit të punës përputhen me objektet pasuri kulturore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 2 Përshkrimi i Objekteve

Pjesë integrale e kësaj marrëveshjeje është lista e detajuar e objekteve të dakortësuara për t'u kthyer.(Shtojca 1).

Neni 3

Transferimi i objekteve në vendin e origjinës

1. Republika e Shqipërisë, nëpërmjet Ministrisë së Kulturës, në përputhje të plotë me legjislacionin e brendshëm:
 - a) do të ndjekë të gjitha procedurat e kthimit dhe transferimit të ikonave në vendin e origjinës nëpërmjet Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, si institucioni përgjegjës dhe që vepron në emër të Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë;
 - b) do të mundësojë lëvizjen e ikonave, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës nga përfaqësuesit e Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, si edhe do të marrë të gjitha masat për të siguruar shoqërimin fizik të këtyre ikonave nga Policia e Shtetit e Republikës së Shqipërisë drejt pikës kufitare me Maqedoninë e Veriut të dakordësuar ndërmjet palëve;
 - c) do të njoftojë Policinë e Shtetit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të Republikës së Shqipërisë në lidhje me këtë lëvizje, për të lehtësuar procedurat e transferimit.
2. Republika e Maqedonisë së Veriut, nëpërmjet Ministrisë së Kulturës:
 - a) do të mundësojë vendosjen në dispozicion të një mjeti transporti, si edhe mënyrën e transportit të sigurt të objekteve (paketimin e tyre), në pikën ku do të fillojë transporti i ikonave si edhe do të shoqërojë ikonat nëpërmjet prezencës së personelit të Ambasadës së Maqedonisë së Veriut në Tiranë ose të punonjësve të autorizuar prej saj.
 - b) do të kujdeset për marrjen përsipër të transferimit të tyre dhe marrjes në dorëzim në territorin asnjëanës të pikës doganore në të cilën palët do të bien dakord, si edhe për sigurinë e tyre fizike në territorin e vendit të origjinës.

Neni 4

Dokumentacioni i transferimit të objekteve

Palët bien dakord për nënshkrimin e një Akti Dorëzimi, për dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të objekteve të parashikuara në këtë Marrëveshje në përputhje me dokumentacionin vijues:

- a) Procesverbalet e sekuestrimit të provave materiale datë 8 dhe 9 tetor 2013 të policisë gjyqësore në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë.

- b) Urdhër Ministri me Prot. nr. 457 datë 28.12.2015 "Mbi Ngritjen e Grupit të Punës për vlerësimin dhe kategorizimin e objekteve të trashëgimisë kulturore, kaluar në pronësi shtetërore, me vendimin e Gjykatës së Apelit nr. 1459, datë 30.09.2015, me qëllim shpërndarjen e tyre në Institucionet Muzeale Kombëtare".
- c) Urdhër Ministri me Prot. nr. 56, datë 04.03.2016, për disa ndryshime në Prot. nr. 457 datë 28.12.2015 "Mbi ngritjen e Grupit të Punës për vlerësimin dhe kategorizimin e objekteve të trashëgimisë kulturore, kaluar në pronësi shtetërore, me vendimin e Gjykatës së Apelit nr. 1459, datë 30.09.2015, me qëllim shpërndarjen e tyre në Institucionet Muzeale Kombëtare".
- d) Vendim nr. 53105-02300-00-2015 i Regjistrat Themeltar, nr. 00-2016-2228 i Vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë.
- e) Raport Përfundimtar i Grupit të Punës të ngritur me Urdhër me Prot. nr. 122 datë 19.02.2018 "Mbi ngritjen e Grupit të Punës për shqyrtimin e praktikës dhe ekspertizën mbi objektet në kuadër të kërkesës së Ministrisë së Kulturës të Republikës së Maqedonisë për disa Ikona që ndodhen në Territorin e Republikës së Shqipërisë".

Neni 5

Menaxhimi i shpenzimeve

1. Palët nuk do të aplikojnë asnjë tarifë doganore ose shuma të tjera mbi pasuritë kulturore të kthyera.
2. Të gjitha shpenzimet të lidhura me kthimin dhe shpërndarjen e pasurive kulturore do të përballohen nga palët kontaktuese në mënyrë të barabartë, siç është rënë dakord paraprakisht.

Neni 6

Hyrja në fuqi dhe Përfundimi

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me anë të së cilës Palët informojnë njëra tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për plotësimin e procedurave të brendshme që nevojiten për hyrjen e saj në fuqi.
2. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi deri në momentin që Palët kanë përmbushur të gjitha detyrimet e saj në përputhje me dispozitat e parashikuara, përveç nëse përfundohet më herët, me njoftim me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 7


Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

1. Mosmarrëveshjet lidhur me dispozitat e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet palëve.

Nënshkruar në Gjup, më 14.11.2022, në 2 kopje origjinale, në gjuhën shqipe, maqedonase, dhe angleze, ku secila prej tyre është njëllëj autentike. Në rast interpretimi të ndryshëm të dispozitave të marrëveshjes, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.


Republika e Shqipërisë
Përfaqësuar nga Ministria e Kulturës

Elva MARGARITI
Ministër



Republika e Maqedonisë së Veriut
Përfaqësuar nga Ministria e Kulturës

Bisera KOSTADINOVSKA-
STOJCEVSKA
Ministër



SHTOJCA I

LISTA E DETAJUAR E OBJEKTEVE

	<u>Nëna e Shenjtë me Krishtin</u> -101x61x4cm, (nr.regjistrimi 6677); Kisha Shën Athanasi, Fshati Dollno Perovo, Komuna Resen; 	<u>Shën Mëria me Krishtin</u> - Ikonë, dru, tempera, anonim, shek. XIX. <u>Kodi OKIPK 67296</u>; Dimensionet: 100 x 60,5 x 3,2 cm. Shënimet në raport: (Shihni shenjat e vendosjes në ikonostas, në anët e poshtme të ikonave nr. 89 dhe 90). Numri 89, 90, 103 mendohet se janë nga i njëjti ikonostas. Mban Nr. Inventari 90. Emërtimi i saktë i vendosur unanimisht nga grupi i ekspertëve pas verifikimit të listave në procesverbalet e sipërcituar dhe vlerësimit fizik të objektit është: "Shën Maria me Krishtin". 
2.	<u>Dyert Mbretërore</u> - Lajmërim 140.5x47x3cm (nr.regjistrimi 6678); Kisha Shën Athanasi, Fshati Dollno Perovo, Komuna Strugë;	<u>Dyert e Bukura</u> (Mban Nr. Inventari 201-206 pasi është e ndarë në 6 pjesë) <u>Profet</u>, pjesë e dyerve të bukura nga Nr.201-206, ikonë, dru, tempera, anonim, shek XIX. <u>Kodi OKIPK 67417</u>; Dimensionet: 49 x 46,4 x 3,5 cm <u>Kryeëngjëlli Gabriel</u>, pjesë e dyerve të bukura, anonim, ikonë, dru, tempera, shek XIX. <u>Kodi OKIPK 67418</u>; Dimensionet: 55,5 x 46 x 3,5 cm <u>Fragment nga dyert e bukura</u>- pjesa e sipërme e derës majtas e gdhendur, anonim, dru, tempera, shek XIX. <u>Kodi OKIPK 67419</u>; Dimensionet: 27,8 x 46,5 x 3 cm <u>Fragment nga dyert e bukura pjesa e sipërme e derës djathtas</u>, e gdhendur, anonim, dru, tempera, shek XIX. <u>Kodi OKIPK 67420</u>; Dimensionet: 29 x 45,5 x 4 cm <u>Shën Mëria</u>, fragment anonim, dru, tempera, shek XIX. <u>Kodi OKIPK 67421</u>; Dimensionet: 53,8 x 45,5 x 4,3 cm <u>Profet</u>, fragment nga dyert e bukura, dru, tempera, anonim, shek XIX. <u>Kodi OKIPK 67422</u>; Dimensionet: 49 x 46,5 x 3,8 cm



3

Jezu Krishti-Lajmërimi 100 x 61 x 4 cm (nr.regjistrimi 6679); Kisha Shën Athanasi, Fshati Dollno Perovo, Komuna Resen;



Krishti Pantokrator Ikonë, dru, tempera, anonim, viti 1869 Kodi OKIPK 67309; Dimensionet: 67,5 x 47,5 x 1,5 cm.

Shënimet në raport: Shënim poshtë në ikonë: me kontributin e Joan Joska, 1 maj 1869. (ikona me nr. 90 ka pasur po këtë shënim, është fshirë.) Numri 89, 90, 103 mendohet se janë nga i njëjti ikonostas.

Mban Nr. Inventari 103

Emërtimi i saktë i vendosur unanimisht nga grupi i ekspertëve pas verifikimit të listave në procesverbalet e sipërcituar dhe vlerësimit fizik të objektit është "Krishti Pantokrator".



4


Shën Dhimitri – 100 x 60 x 3.5cm (nr.regj.6681); Kisha Shën Athanasi, Fshati Dollno Perovo, Komuna Strugë;



Shën Dhimitri Ikonë, dru, tempera, anonim, shek. XIX. Kodi QKIPK 67295; Dimensionet: 99,5 x 59,5 x 4 cm.

Shënimet në raport: Shënim sipër në ikonë: Shën Dhimitri. Shënim poshtë në ikonë: "me kontributet e Pjetrit dhe të miat, Pavlit" (Pavli është piktori).

Numri 89, 90, 103 mendohet se janë nga i njëjti ikonostas. Mban Nr. Inventari 89.



Takimi i Krishtit – 35 x 25 x 2cm (nr.regjistrimi 6683); Kisha Shën Athanasi, Fshati Dollno Perovo, Komuna




Prezantimi i Krishtit në Tempull Ipapandia, Ikonë, dru, tempera, anonim, shek XVIII-XIX, Kodi QKIPK 67263, Dimensionet: 35,5 x 30,2 x 2 cm. Mban Nr. Inventari 56.




Pagëzimi i Krishtit – 35 x 30 x 2cm (nr.regjistrimi 6684); Kisha Shën Athanasi, Fshati Dollno Perovo, Komuna Strugë.



Pagëzimi i Krishtit, Ikonë, dru, tempera, anonim, shek. XIX, Kodi QKIPK 67291, Dimensionet: 35,5 x 30 x 2 cm. Mban Nr. Inventari 85.



7. Shën Gjergji – 75 x 50 x 5 cm, piktur i ikonave Dicho (nr.regjistrimi 7391); Kisha Shën Athanasi/Nikolla, Fshati Selci, Komuna Strugë; 	Shën Gjergji, Ikonë, dru, tempera, anonim, shek. XIX; Kodi QKIPK 67271; Dimensionet: 73,3 x 50,8 x 1,6 cm. Mban Nr. Inventari 64. 
8. Shën Athanasi- 90 x 50 x 4 cm (nr.regjistrimi 7352); Kisha Nënna e Shenjtë (Sh.Bogorodica), Fshati Burunec, Komuna Bitola/Strugë. 	Shën Athanasi Ikonë, dru, tempera, anonim, shek. XIX; Kodi QKIPK 67267; Dimensionet: 90,5 x 50 x 2 cm; Mbi ikonë është shkruar data e realizimit, 23 gusht 1899 (e pikturuar) nga Nikolla Avramov dhe Kosta Kolof nga Lazaropole i Dibrës. Mban Nr. Inventari 60. Emërtimi i saktë i vendosur unanimisht nga grupi i ekspertëve pas verifikimit të listave në procesverbalet e sipërcituar dhe vlerësimit fizik të objektit është: "Shën Athanasi". 

9.	Shën Nikolla - 90x53x2.5cm (nr.regjistrimit 7360); Kisha Nëna e Shenjtë (Sh.Bogorodica), Fshati Burinec, Komuna Bitola/Strugë. 	Shën Nikolla Ikonë, dru, tempera, anonim, shek. XIX; Kodi QKIPK 67299; Dimensionet: 90,2 x 52,2 x 3 cm. Mban Nr. Inventari 93. Emërtimi i saktë i vendosur unanimisht nga grupi i ekspertëve pas verifikimit të listave në procesverbalet e sipërcituar dhe vlerësimit fizik të objektit është: "Shën Nikolla". 
10.	Deisis (Krishti, Nëna e Perëndisë dhe Gjon Pagëzori). piktori Serafim - 68x43x3cm (nr.regjistrimit 7355); Kisha Nëna e Shenjtë (Sh.Bogorodica), Fshati Burinec, Komuna Bitola/Strugë. 	Skena Deisis; Ikonë, dru, tempera, anonim, 43.8x68x2.7cm shek. XIX; Kodi QKIPK 67284; Dimensionet: 67,5 x 43,5 x 3 cm. Mban Nr. Inventari 78. Emërtimi i saktë i vendosur unanimisht nga grupi i ekspertëve pas verifikimit të listave në procesverbalet e sipërcituar dhe vlerësimit fizik të objektit është: "Skena Deisis". 

11.	Shën Nikolla - 74x48x3 cm (nr.regjistrimi 597); Kisha e Shën Nikollës (Sh.Nikolla), fshati Radozhda, komuna Strugë. 	Shën Nikolla Ikonë, dru, tempera, anonim, shek XIX; Kodi QKIPK 67269; Dimensionet: 72,5 x 48,5 x 3 cm. Mban Nr. Inventari 62. Emërtimi i saktë i vendosur unanimisht nga grupi i ekspertëve pas verifikimit të listave në procesverbalet e sipërcituar dhe vlerësimit fizik të objektit është: "Shën Nikolla". 
12.	Nëna e Shenjtë me Krishtin - 73x49x3 cm, (nr.regjistrimi 598); Kisha e Shën Nikollës (Sh.Nikolla), fshati Radozhda, komuna Strugë. 	Shën Mëria me Krishtin; ikonë, dru, tempera, anonim, 73.5x 49.5x2.3 cm shek. XVIII-XIX; Kodi QKIPK 67303; Dimensionet: 73,5 x 49,5 x 2,3 cm. Mban Nr. Inventari 97. Emërtimi i saktë i vendosur unanimisht nga grupi i ekspertëve pas verifikimit të listave në procesverbalet e sipërcituar dhe vlerësimit fizik të objektit është: "Shën Mëria me Krishtin". 

13. Jezu Krishti - 73x49.5x3 cm, (nr.regjistrimi 599); Kisha e Shën Nikollës (Sh.Nikolla), fshati Radozhda, komuna Strugë.
- Krishti Pantokrator; ikonë, dru, tempera, anonim, shek. XVIII; Kodi QKIPK 67302; Dimensionet: 73,3 x 49 x 3,2 cm. Mban Nr. Inventari 96. Emërtimi i saktë i vendosur unanimisht nga grupi i ekspertëve pas verifikimit të listave në procesverbalet e sipërcituar dhe vlerësimit fizik të objektit, është: "Krishti Pantokrator".



14. Shën Vasili - 95x57x5 cm, (nr.regjistrimi 6496); Kisha Nëna e Shenjtë (Sh.Bogorodica), Fshati Burunec, Komuna Strugë.
- Shën Thanasi; ikonë, dru, tempera, anonim, 95.3x57x3.5cm shek. XIX; Kodi QKIPK 67306; Dimensionet: 95,2 x 57 x 3,5 cm. Mban Nr. Inventari 100. Emërtimi i saktë i vendosur unanimisht nga grupi i ekspertëve pas verifikimit të listave në procesverbalet e sipërcituar dhe vlerësimit fizik të objektit, është: "Shën Thanasi".



15. Jezu Krishti - 93x57x3.5 cm, (nr.regjistrimi 6499); Kisha Nëna e Shenjtë (Sh.Bogorodica), Fshati Gjavato, Komuna Strugë.
- Krishti në Fron; Ikonë, dru, tempera, anonim, shek. XIX; Kodi QKIPK 6728; Dimensionet: 93,5 x 56,5 x 3,5 cm. Mban Nr. Inventari 75. Emërtimi i saktë i vendosur unanimisht nga grupi i ekspertëve pas verifikimit të listave në procesverbalet e sipërcituar dhe vlerësimit fizik të objektit është: "Krishti në fron".



16. Shën Harallambi - 93x50x2.5 cm, (nr.regjistrimi 6501); Kisha Nëna e Shenjtë (Sh.Bogorodica), Fshati Gjavato, Komuna Resnje.
- Shën Harallambi, Ikonë, dru, tempera, anonim, shek. XVIII-XIX, Kodi QKIPK 67304; Dimensionet: 93,2 x 55,7 x 3 cm. Mban Nr. Inventari 98. Emërtimi i saktë i vendosur unanimisht nga grupi i ekspertëve pas verifikimit të listave në procesverbalet e sipërcituar dhe vlerësimit fizik të objektit është: "Shën Harallambi".



17.

Ngjitja e Profetit Ilia- piktor i ikonave Dicho, 70x50x2cm (nr.regjistrimit 7393); Kisha Shën Athanasi/Nikolla, (Sh.Nikolla), Fshati Radozhda, Komuna Strugë.

NUK KA FOTOGRAFI

Profeti Ilia. Ikona paraqet jetën e Profetit Ilia në dy skena. Në pjesën e sipërme paraqitet Profeti Ilia me karrocë dhe kuaj të kuq, vendosur në sfond qiellor me ngjyrë të kuqe. Në pjesën e poshtme paraqitet Elizeu, me pergamenë në dorë, dhe në të majtë të tij në shpellë ndodhet Profeti Ilia që ushqehet nga korbë. Dimensionet: 72 x 52 x 2 cm.




18.

Sakrificia e Profet Ilia - Avram Dicho, (nuk është identifikuar), Kisha Shën Athanasi/Nikolla, (Sh.Nikolla), Fshati Radozhda, Komuna Strugë.



Profeti Ilia mund Pritërinjtë e Baalit; Ikonë, dru, tempera, anonim, 80.5 x 51.3 x 1.3cm shek. XIX (e ndarë në dy pjesë), Kodi QKIPK 67322; Dimensionet: 80,5 x 51,3 x 1,3 cm. Tekstet e ikonës janë shkruar me gërma cirilike. Mban Nr. Inventari 116.



19.

Kryeëngjëlli Mëshill - Kisha
Shën Athanasi/Nikolla,
(Sh.Nikolla), Fshati Radozhda,
Komuna Strugë;
nuk është identifikuar.



Kryeëngjëlli Mëshill Ikonë, dru, tempera, anonim.shek. XIX, Kodi QKIPK 67305, Dimensionet: 100 x 51 x 2 cm. Mban Nr. Inventari 99.

Emërtimi i saktë i vendosur unanimisht nga grupi i ekspertëve pas verifikimit të listave në procesverbalet e sipërcituar dhe vlerësimit fizik të objektit është: "Kryeëngjëlli Mihail (Mëshill)".



20.

Ikja e Lotit dhe vajzave -
Avram Dichev.



Shkatërrimi i Sodomës dhe Gomorrës (skenë nga Dhiata e Vjetër). Në objekt paraqiten tre figura. E para është pjesërisht e dukshme. E dyta është veshur me të kuqe dhe tjetra me blu. Sipër figurave zhvillohet peizazhi, në të cilin paraqitet qyteti i Sodomës që digjet në tym e flakë. Në sipërfaqe janë të shkruara gërmja cirilike.

Dimensionet: 80.6 x 30 x 1.5 cm.

